



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivered	22. 11. 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHEK	7052/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.Nr.1236/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malësore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Rushit Kajtazi, Zyrtar i lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1236/2023, të datës 02.10.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë-Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike „kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 21.11.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1236/2023, e datës 02.10.2023, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.1374/2023, i datës 06.09.2023, i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi kandidat për shërbim civil, më datë 02.10.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1374/2023, të datës 06.09.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore se me rastin e aplikimit ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas konkursit.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 6986/2023, të datës 15.11.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.1236/2023, të datës 02.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptime të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6349/2023, të datës 02.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK, Vendimin me numër protokollit Nr. 1374/2023, të datës 06.09.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; emali i datës 05.06.2023 nga ankuesi tw H.Z-DMZP-ja; Vendimin numër A. Nr. 877/2023, i datës 04.08.2023, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; email i datës 08.11.2023 nga R. Kajtazi për A. Kambera, email nga ankuesi i datës 15.11.2023 për ankesa KPSHC bashkangjitur aplikacioni, ankesa dhe email-atchmen; ankesën me numër protokollit 4877/2023 të datës 22.06.2023 të parashtruar nga ankuesi E.Z në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Certifikatë mbi dënimet penale e lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Pasqyra e Llogarisë së trustit për periudhën prej datës 25.04.2022-25.04.2023; Vendim i datës 05.06.2023 me nr.30/2023 për refuzimin e aplikacionit të i Lëshuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Vendimi me Nr.3/2023 i datës 14.06.2023 i lëshuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit; Ankesa e datës 06.06.2023 parashtruar nga ankuesi në Divizionin për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit DMZP/MPB; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 27.06.2023; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 30.06.2023 bashkë me shkresat e lëndës; Ofrimi i dëshmimeve nga organi i punësimit të datës 29.06.2023 me numër protokollit 1040; Konkursi me numër reference RN0001 140, për pozitën Specialist të Përgjithshëm të Shkencave Politike; Vendimi Nr.05/142 i datës 10.05.2025 për emërimin e Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialist i Përgjithshëm i Shkencave Politike; Lista e aplikantëve; Lista e kandidatëve në pritje; Lista e kandidatëve të aprovuar; Lista e kandidatëve të refuzuar; Njoftimi i datës 05.06.2023 për listën e ngushtë; Njoftim i datës 14.06.2023 plotësim ndryshimi i listës së ngushtë; Rezultati i testit me shkrim; Aplikacioni i datës 04.05.2023 i ankuesit se bashku me dokumentacionin si: Diploma e datës 04.06.1998 e shkollës së mesme e lëshuar nga Gjimnazi në Istog; Diploma Nr.625 e datës 28.05.2008, e lëshuar nga Fakulteti Filozofik Universiteti i Prishtinës; Diploma Master e datës 23.05.2018 Nr.D-28/16 e lëshuar nga Kolegji ISPE; Certifikatë (urkunde) Master i studimeve Evropiane të datës 26.10.2022; certifikate e pjesëmarrjes ne trajnin e datës 20.10.2022, Letër Reference e datës 30.12.2009 nga Kolegji West Lothian; Letër e punësimit e datës 04.11.2016 e lëshuar nga Unioni Evropian; Letër e punësimit e datës 03.12.2018 e lëshuar nga Unioni Europian; Performancë e datës 11.02.2022 për Rekomandim i datës 11.06.2022 i lëshuar nga Universiteti BONN; kopja e Letërnjoftimit; Certifikatë Shëndetësore e datës 02.03.2023; Master i studimeve Evropiane në Universitetin BONN; Certifikatë për studimet master e lëshuar nga Universiteti BONN dhe Certifikatë me Nr.544/22 e datës 02.05.2023 e lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Istog.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të pabazuara pretendimet ankimore të ankueses, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me datë 06.04.2023, ka publikuar në sistemin elektronik-SIMBNJ, Konkursin për praninë, me numër reference RN00011404, për emrin e grupit *Specialistë të Përgjithshëm të Shkencave Politike*, titulli i vendit të punës „ *Zyrtar i Misionit Diplomantik*”, klasa “ profesional 2”, tetë (8) vende pune.

Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 27.04.2023 deri me datë 06.05.2023, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

Në fazën e shqyrtimit paraprak, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me Vendimin Nr.30/2023, të datës 05.06.2023, ka refuzuar aplikacionin e ankuesit, me arsyetimin se i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara me konkurs gjegjesisht dëshmi lidhur me njohjen e gjuhës angleze si dhe certifikatë nga gjykata ose Këshilli Gjyqësor që dëshmohet së nuk ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë.

Pas ankesës se ankuesit kundër Vendimit Nr.30/2023, të datës 05.06.2023, Njësia Përgjegjësi me Vendimin Nr.3/2023, të datës 14.06.2023, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e ankuesit ashtu që vërtetohet së ankuesi ka sjell dëshmi të mjaftueshme për njohjen e gjuhës angleze, ndërsa konstatohet së ankuesi nuk ka sjell dëshmi nga gjykata apo Këshilli Gjyqësor së i njëjti nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo me të vjetër së gjashtë muaj nga data e lëshimit si dhe nuk ka ofruar dëshmi lidhur me përvojën e punës që duhet të jetë vërtetim apo reference e mbështetur më pasqyrën e pagesave të fundit të kursimeve pensionale ose pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale, dëshmi këto të përcaktuar me konkurs.

Ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshill, ndërsa ky i fundit me Vendim A.nr. 877/2023, të datës 04.08.2023, ka anuluar Vendimin Nr.3/2023, të datës 14.06.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim të organi që ka nxjerrë aktin e anuluar, me detyrimin që Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të vendimit, të bëjë rishqyrtimi në aplikacionit të ankuesit

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në zbatim të vendimit të Këshillit A.nr.877/2023, me Vendimi Nr.1374/2023,të datës 06.09.2023, ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e ankuesit ashtu që ankuesi nuk kualifikohet për vazhdim te mëtejme në procedurë të pranimit sipas konkursit më numër të referncës RN0001140, me arsyetimin se edhe pas rishqyrtimit të aplikacionit të ankuesit, i njëjti nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara me konkursi: Certifikatën nga gjykata apo Këshilli Gjyqësor së i njëjti nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo me të vjetër së gjashtë muaj nga data e lëshimit; kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave ju bashkëngjitet se paku njëra nga dëshmitë mbështesë si në vijim: pasqyrën e pagesave të fundit të kursimeve pensionale ose pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale.

Kundër Vendimit Nr.1374/2023, të datës 06.09.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, nanurisa parashtron ankesë në Këshill, me pretendimet ankimore se me rastin e aplikimit ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara sipas konkursit.

Lidhur me shqyrtimin e bazushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave ligjore në fuqi përkitazi me procedurën e pranimit të nëpunësve civil, gjegjesisht:

-Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, ku Neni 34 përcaktohet: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik.

Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike. 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshkrimin e përgjithshëm të punës për grupin përkatës, pozitat e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët, afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi...

-Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku neni 9 parasheh se : "1. Shpallja e një procedure konkurrimi publikohet nga Njësia Përgjegjëse në uebfaqen unike të procedurave të konkurrimit dhe emërimit, pjesë e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (në tekstin e mëtejme: "SIMBNJ"). 2. Përveçse përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, shpallja e konkurimit publikohet, sipas rastit edhe në: 2.1. ueb faqen e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, për konkurimet për pranimin në shërbimin civil në Institucionet e Administratës Shtetërore, si dhe në uebfaqet e secilit institucion të administratës shtetërore si vegëz e veçantë e ndërlidhur me SIMBNJ apo në; 2.2. ueb faqen e Institucionit Tjetër Shtetëror për konkurimet për pranimin në këto institucione. 3. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit, shpallet në një afat jo më të shkurtër se njëzetë e një ditë (21) ditë kalendarike, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse. Afati për pranimin e aplikacioneve, nuk mund të jetë më i shkurtër se tetë (8) ditë dhe jo më i gjatë se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike. ...", Neni 10 përcakton se: 1. Shpallja e konkurimit për një Grup të caktuar përmban, të paktën, këto të dhëna: 1.1. përshkrimin e përgjithshëm të punës së Grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 1.2. Kërkesat e përgjithshme për pranim sipas nenit 8 të LZP; 1.3. kërkesat e përgjithshme formale; 1.4. njohuritë, aftësitë dhe cilësitë që vlerësohen në procedurën e konkurrimit (kërkesat e përgjithshme të nevojshme); 1.5. listën e pozitave, aktualisht të lira, të Grupit për të cilin zhvillohet konkurimi; 1.6. mënyrën për paraqitjen e aplikacioneve; 1.7. afatin përfundimtar për pranimin e aplikacioneve të përcaktuar me datë të saktë kalendarike; 1.8. dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikacionit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre; 1.9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve; 1.10. mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët...", Neni 12 përcakton se: Përmbajtja e aplikacioneve 1. Aplikacioni përmbanë këto të dhëna: 1.1. një referencë në shpalljen e konkurimit; 1.2. të dhënat personale të kandidatit; 1.3. nivelin e arsimit si dhe diplomat e fituara, institucionet arsimore, datat e diplomimit; 1.4. një përshkrim të hollësishëm të përvojës së punës, duke përfshirë: emrin e punëdhënësit, funksionet, titujt, rangjet, kohëzgjatja e punës, një përshkrim i shkurtër i detyrave, numri dhe lloji i personelit nën mbikëqyrje, adresa e punëdhënësit, arsytet për largimin nga vendi i punës; 1.5. njohuritë gjuhësore; 1.6. informata mbi trajnimet e veçanta të kryera, kualifikimet profesionale dhe specializimet, aftësitë e veçanta dhe publikimet; 1.7. njohuritë kompjuterike; 1.8. emri, adresa dhe

numri i kontaktit të dy (2) personave referues; 2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurimit dhe të deklaruara në aplikacion. Neni 14 përcakton se: Neni 14 Fazat e konkurrimit 1.Konkurimi për pranimin në shërbimin civil, përfshin dy faza: 1.1. Verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. Vlerësimi i kandidatëve. Neni 15 përcakton se: 1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë. 4.Kandidatët të cilët plotësojnë kushtet për aplikim renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista shpallet në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj.

Në kuptim të kuadrit ligjor si me sipër, kolegji ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit me numër referencë RN00011404, dhe si rrjdhobjë është konstatuar se si kërkesa të përgjithshme formale lidhur me këtë pozitë janë përcaktuar:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, në shkencat politike/administratë publike/politika sociale/juridik;

Kualifikimet e posaçme formale: Njohja e gjuhesh angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimi nga një institucionit i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë.

Përvoja e punës e kërkuar: së paku një (1) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Ndërsa në klauzolën numër 7 të konkursit si dëshmi janë kërkuar:

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin për diplomat jashtë vendit;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjitet së paku njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopjet e dëshmisë së njohjes së gjuhës angleze. Njohja e gjuhës angleze dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime universitare të kryera në këtë gjuhë;

- Dëshmi përkatëse se kandidati/ja ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Dëshmi mjekësore se kandidati/ja është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës;
- Certifikatë /vërtetim nga Gjykata ose nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilën dëshmohet se nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojën e kërkuar të punës, është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilën dëshmohet se ai/ajo nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 8 paragrafi 1, nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Nga analizimi i provave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi posedon Diplomën Nr.625 të datës 28 maj 2008, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, sipas së cilës ankuesi me datë 27.04.2007, ka përfunduar studimet themelore dega e Administratës Publike; Diplomën Nr.D-28/2018 e datës 23.05.2018 të lëshuar nga Kolegji ISPE, për përfundimin e programit Master i Arteve, në Studime Evropiane me Specializim në Politikat e BE-së, si dhe Dëshmi për përfundimin e Master i Studimeve Evropiane në Universitetin BONN; pra ankuesi ka plotësuar kriterin e arsimit. Kurse lidhur me përvojën e punës ka ofruar vërtetimin e datës 04.11.2016, të lëshuar nga Udhëheqësi Burimeve Njerëzore të EULEX-it (Evropian Union Rule of Law Mision in Kosovo), sipas të cilës dëshmohet së ankuesi ka punuar si përkthyes i gjuhës shqip/anglisht dhe anasjelltas, për periudhën nga data 11.02.2010 deri me 14.11.2016; Vërtetimin e datës 03.12.2018, të lëshuar nga Udhëheqësi Burimeve Njerëzore të EULEX-it , Evropian Union Rule of Law Mision in Kosovo, sipas të cilës dëshmohet së ankuesi ka punuar si përkthyes shqip/anglist dhe anasjelltas, për periudhën kohore nga data 01.02.2018 deri 14.12.2018. Po ashtu ankuesi si dëshmi lidhur me përvojën e punës ka prezantuar shkresën pa emërtim dhe pa nënshkrim, të lëshuar nga Drejtori i projektit “ Strengthening the Justice System of Kosova”, sipas të cilit thuhet se ankuesi është duke punuar si përkthyes nga 31.03.2022 në këtë projekt në kohëzgjatje katër (4) vjeçare, si dhe shkresën e datës 30.12.2009, nga West Lothian College, pa emërtim dhe nënshkrim, sipas të cilës thuhet së ankuesi ka qenë i punësuar në Këshillin Britanik, duke specifikuar vetëm periudhën e fillimit maj 2007, ndërsa nuk specifikohet koha e mbarimit, dëshmi këto që në vlerësimin e Kolegjit nuk janë të mjaftueshme dhe të vlefshme për vërtetimin e përvojës së punës nëse të njëjtat nuk mbështeten edhe me fakte tjera shtesa si dëshmi nga Trusti Pensional apo nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Rrjedhimisht, Kolegji konstaton së dëshmia e lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të EULEX-it- Evropian Union Rule of Law Mision in Kosovo, për periudhën nga data 11.02.2010 deri me 14.11.2016, si dhe nga data 01.02.2018 deri 14.12.2018, është dëshmi e vlefshme për vërtetimin e përvojës së punës siç përcaktohet me nenin 6 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, mirëpo, në vlerësimin e Kolegjit, ankuesi nuk posedon përvojën e punës lidhur me fushën e arsimit sipas konkursit.

Ndërsa, lidhur me dëshmitë sipas klauzolës nr.7 të konkursit, Kolegji ka gjetur se edhe në procedurë të rishqyrtimit, njësia përgjegjëse ka konstatuar së ankuesi me rastin e aplikimit nuk kishte dorëzuar dëshmi nga organi kompetent se i njëjti nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje dhe se ankuesi as në procedurë të ankesës me asnjë provë nuk ka arritur të argumentoj se i njëjti me rastin e aplikimit ka dorëzuar një dëshmi të tillë.

Andaj, bazuar në konstatimet si me sipër, se ankuesi nuk ka plotësuar kriterin lidhur me përvojën e punës sipas konkursit dhe si i njëjti nuk ka dorëzuar dëshmi certifikatë për dënime penale, rezulton së Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.1374/2023 të datës 05.09.2023, ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht nenin 10 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 ku përcaktohet se: “Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”; nenin 12 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 ku theksohet se: Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit... si dhe nenin 15 paragrafin 5 ku përcaktohet se: 5.”Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të ë të vazhdojnë më tej konkurimin”.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1236/2023

Rushit Kajtazi

Procesmbajtësi

Arbita Ilaxhikaq Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në MPB; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.